

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Revolta qytetare - Protesta e 107/ 'Lironi djemtë e diasporës', protestuesi: Qeveria duhet të rrëzohet
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916666/protesta-e-107-lironi-djemte-e-diaspores-protestues-i-qeveria-duhet-te-rrrezohet/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:48:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:39:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c7417c66f156351a56b33bad53dc51fad1d7010de5be49c40427f2d295c76638
TEKSTI	b812a1d662035e7b310b7bedadf228e30fc2f041fd27f612e8eea416b209df20
PAMJA	b987778274dbf9409c26ce572810eb0bdf31e457d977f413de33e87885a8abd8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7de23a62ebc2edc0c62274115ab998ec9b45bf12a2053f9458653ab3bf99f45e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7de23a62ebc2edc0c62274115ab998ec9b45bf12a2053f9458653ab3bf99f45e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

LAJMI I FUNDIT

ÇIM PEKA LIVE/ Audiopërgjimi i ri i Ron Yeffet



Protesta e 107/ 'Lironi djemtë e diasporës', protestuesi: Qeveria duhet të rrëzohet

20:39, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Në protestën e 107, një prej protestuesve akuzoi qeverinë për arrestimin dhe dhunimin e 24 të rinjve të diasporës, mes tyre Bekim Imerajn, duke kërkuar lirin e tyre.

Ai e cilësoi ndërhyrjen e policisë si dhunë të panevojshme dhe pretendoi se janë shkelur të drejtat e protestuesve të garantuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në fjalën e tij, protestuesi e lidhi revoltën me akuzat për korrupsion dhe keqqeverisje, ndërsa deklaroi se protestat duhet të vijojnë deri në largimin e qeverisë.

Ai kërkoj që pas rrëzimit të saj vendi të drejtohet nga një qeveri teknike, ndërsa propozoi dënim deri në 25 vite burg për korrupsionin.

"Aleanca është me ju", u shpreh ai, duke i bërë thirrje qytetarëve dhe diasporës të vijojnë rezistencën.

Fjala e tij:



Të dashur qytetarë, qytetare, mirëmbërë! Bekim Imeraj dhe 23 djemtë e diasporës janë arrestuar dhe janë dënuar sot sepse ato patën kurajon të dalin ngjeshur dhe t'i thonë kësaj qeverie: "mjaft na ke vjedhur, mjaft na ke mjelur, mjaft na ke shitur dhe na ke tradhtuar atdheun!" Ndaj, t'i thërrasim së bashku: Lironi djemtë e diasporës! Lironi djemtë e diasporës! Lironi djemtë e diasporës! T'i llojmë nga komisariati numër 3, të gjithë bashkë!

Diaspora në 36 vite i ka sjellur remitanca kombit tonë, 35% e GDP-së vjen nga diaspora. Dhe diktatori i fundit e shpërblen diasporën me dhunë dhe me arrestime. Lironi djemtë e diasporës! Lironi djemtë e diasporës! Lironi djemtë e diasporës! Dhuna, dhuna ishte disproporcionale dhe e panevojshme, sepse një nga djemtë e diasporës ishte komplet i neutralizuar dhe asnjë rrezik për forcat e rendit. Dhe sërish ato e goditën dhe e dhunuan. Policia e shtetit e

më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rrimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina

diktatures se Iranes, kane dhunuar Konventen Evropiane te te Drejtave te Njeriut. Shqipëria është anëtare e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Dhe me aktin e sotëm të arrestimit dhe dhunimit të djemve të diasporës...

Të gjithë shqiptarët e kanë parë, sepse videot e dhunës sot kanë dalë virale dhe të gjithë e kanë dëshmuar. Shqipëria është anëtare e Konventës së të Drejtave të Njeriut, dhe sot me dhunën që ata kanë bërë, ato kanë dhunuar artikullin 3 të Konventës së të Drejtave të Njeriut, sepse artikulli 3 thotë dhe citon kështu: "Qeveria duhet të garantojë që të mos dhunohen dhe të mos keqtrajtohen qytetarët kur ato protestojnë". Por ato kanë bërë të kundërtën, i kanë arrestuar dhe i kanë dhunuar!

Ato kanë dhunuar artikullin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse ato ishin aty duke shprehur të drejtën e fjalës, pra fjalën e lirë, duke protestuar, duke i thënë kryeministrit: "Mjaft na ke vjedhur" dhe asgjë më shumë! Policia e diktatorit të fundit ka dhunuar dhe artikullin 11 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse është e drejta e qytetarëve shqiptarë që të mbledhen në shesh dhe të protestojnë. Dhe ato u goditën, u dhunuan, për të ndaluar këtë protestë. Ndaj, qytetarë të dashur, ju jeni këtu prej më shumë se 180 ditësh. Dhe Aleanca është vetëm me ju. Ky njeri nuk i ka ditët e gjata. Do vijë një ditë që do jeni ju që do rrëzoni atë, së bashku me diasporën. Ndaj, rezistoni! Rezistoni dhe vetëm rezistoni! Se Aleanca është me ju, se vetëm ju duhet të demokratizoni këtë vend. Kanceri i një kombi është korrupsioni.

Dhe ne do ta luftojmë kancerin, korrupsionin, dhe do e ngrimë kombin! Një komb që zgjohet, ngrihet! Kur ta rrëzojmë diktaturën e fundit, e vetmja mënyrë për ta demokratizuar atdheun do jetë një qeveri tranzitore, qeveri teknike. Dhe aleanca e qeverisë tranzitore do jetë me ju. Nëse kjo qeveri do jetë në pushtet 365 ditë, 365 ditë duhet të qëndroni këtu! Dhe akti i parë që duhet të kalojë në parlament, që të fillojë me qeverinë tranzitore, që nga kryeministri i qeverisë tranzitore dhe të gjithë drejtorët: korrupsionin ta dënojnë me 25 vite burg! Që kushdo të vijë nesër në pushtet, kur ta demokratizojmë atdheun, ta dinë se korrupsioni i fut në burg dhe s'dalin më të gjallë nga burgu! Ndaj, Aleanca është me ju. Rezistoni, qëndroni, deri sa ta demokratizojmë atdheun.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Rama jep dorëheqjen!'/ Përfundojnë fjalimet, protestuesit rinisin marshimin



'Nuk frikësohemi dhe nuk tërhiqemi', Luçjana Kokaj: Do jemi në shesh deri sa Edi Rama të largohet



'Mos u kthe me në Shqipëri'/ Edi Rama sulmon me thonj dhe kërcënon emigrantin shqiptar në Napoli: Të zhduk

i perket kështu Lavdena, po zbulues historia



'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës



SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre



'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto


TË NGJASHME



'Rama është delegjitimuar politikisht': Alizoti: Qeveria po fshihet përballë skandaleve



Polici goditi qytetarin gjatë protestës, Krenar Ahmeti: U sulmua në mënyrë brutale! Shkelje e të gjitha normave



Beqiraj: Numri i punonjësve të UKT-së Zagreb dhe UKT-së Tiranë, historia e pyetjes që la pa gjumë japonezin!



'Studentët e demaskuan hajduten', Tepelena: SPAK deklaroi vilën e 3-të të Ballukut, pensionisti nuk siguron ilaçet!



'Territorialja'/ Divjaka kundër bashkimit me Lubnën: Gati relaçioni



Protesta e 107-të/ Nis marshimi drejt Kryeministritë, protestuesit: Rama ian



Bardhi: Nëse Veliaj del nga burgu, me vendim të C-Il -ku do të jetë funerali

Agjencia e Lajmeve SYRI.net
për në Kuvend

Agjencia e Lajmeve SYRI.net
dorëheqjen!

Agjencia e Lajmeve SYRI.net
përfundimtar i Reformës në Drejtësi

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.